



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 13.11.2019 ne Lipjan ndërmjet:

- Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Adem Duriqi në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues dhe

Emri i Kontraktuesit Operatori ekonomik "Endi" Shpk nga Prishtina të cilin e përfaqëson Hajrullah Hajrullahu drejtor në vazhdim përdoret (shkurtesa) Kontraktuesi

Titulli i Kontratës: "Furnizimi i qerdhës dhe i maternitetit ne QKMF me mallra të ndryshme"

Nr referues i kontratës 613 019 129 136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është: "**Furnizimi i qerdhës dhe i maternitetit ne QKMF me mallra të ndryshme**" te gjitha te parapara te pershkrimi i çmimeve.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me vënien e nënshkrimit nga te dy palët, gjegjësisht me 13.11.2019 dhe përfundon maksimumi 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve është **Qerdhja dhe QKMF ne Lipjan**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata Komunale Lipjan.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm i kontratës shprehur në shifra është **2,963.00€** me fjalë dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre /euro/ e zero /cent/

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pagesa do të bëhet pas furnizimit të të gjitha mallrave

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës nëse fatura e ka të bashkangjitur raportin e menaxherit të kontratës se shërbimet janë kryer me cilësi dhe në afat sipas planit dinamik të paraparë në kontratë. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në material. Kontraktuesi do të garantojë se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet dhe kryejnë funksionin pa pengesa.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,5% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë mallrat që janë përgatitur për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse ato kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Menaxher i kontratës është Ismet Ahmeti.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën komunale në Lipjan* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14**Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqip** në 4 origjinale, 3 origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues**Për Operatorin Ekonomik**

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Hajrullah Hajrullahu
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

Nr.	EMRI I ARTIKULLIT	PËRMBAJTJA E ARTIKULLIT	SASIA	NJËSIA MATËSE	ÇMIMI	VLERA
1	Jorgan për fëmijë moshë 1-3 vjeç (dim. 50x125 cm)	Përmasa: 50x125 cm (Gjerësia & gjatësia) Materiali: I mbushur me fibra100% Pambuk organik I Ajrosshëm, i ngrohtë, dhe i këndshëm për prekje Mikrofibra hipoalergjik (Anti alergjik) Lahet ne makinë në 40°C Ngjyra: Preferohen një ngjyrëshe e bardhë	30	Copë	4	120.00
2	Jorgan për fëmijë moshë 3-5 vjeç (dim. 100x150 cm)	Përmasa: 100x150 cm (Gjerësia & gjatësia) Materiali: I mbushur me fibra100% Pambuk organik I Ajrosshëm, i ngrohtë, dhe i këndshëm për prekje Mikrofibra hipoalergjik (Anti alergjik) Lahet ne makinë larëse në 40°C Ngjyra: Preferohen një ngjyrëshe e bardhë	60	Copë	5	300.00
3	Mbulesë për jorgan (Postava dim. 60x135 cm)	Përmasa: 60x135 cm (Gjerësia & gjatësia) Materiali: I mbushur me fibra100% Pambuk organik E ngrohtë, dhe ebutë për prekje Mikrofibra hipoalergjik (Anti alergjik) Mbyllje me zingjir Lahet ne makinë larëse në 60°C Ngjyra: Preferohen një ngjyrësherozë dhe kaltër si dhe ilustruar me figura për fëmijë	30	Copë	4.50	135.00
4	Mbulesë për jorgan (Postava dim. 105x145 cm)	Përmasa: 60x135 cm (Gjerësia & gjatësia) Materiali: 100% Pambuk organik E ngrohtë, dhe ebutë për prekje Mikrofibra hipoalergjik (Anti alergjik) Mbyllje me zingjir Lahet ne makinë larëse në 60°C Ngjyra: Preferohen një ngjyrësherozë dhe kaltër si dhe ilustruar me figura për fëmijë	60	Copë	5.50	330.00

5	Mbështjellës për dyshek pjesa e fundit me lastik për fëmijë mosha 1-3 vjeç (dim. 100x150 cm)	Përmasa: Mbështjellës për dyshek pjesa e fundit me lastik për fëmijë mosha 1-3 vjeç(dim. 100x150 cm) Materiali: 100% pambuk Stabilizon temperaturën trupore Anti-alergjik Fundin me lastik për qëndrim në dyshek gjatë fjetjesLahet ne makinë larëse në 40°C Ngjyra: Preferohen me mbështjellës me ngjyra dhe figuramemacet dhe lepurushat në pyll te dashura për fëmijë	30	Copë	4.50	135.00
6	Mbështjellës për dyshek pjesa e fundit me lastik për fëmijë mosha 1-5 vjeç (dim. 115x175 cm)	Përmasa: Mbështjellës për dyshek pjesa e fundit me lastik për fëmijë mosha 1-5vjeç (dim. 115x175 cm) Materiali: 100% pambuk Stabilizon temperaturën trupore Anti-alergjik Fundin me lastik për qëndrim në dyshek gjatë fjetjes Lahet ne makinë larëse në 40°C Ngjyra: Preferohen me mbështjellës me dizajnin përplot ngjyra të anijeve kozmike dhe planetëve ose një qiell përplot yje.	60	Copë	6.50	390.00
7	Jastëk (dim.50x100 cm)	Përmasa: Jastëk (dim.50x100 cm) Materiali: 100% pambuk me mikrofibra natyrale Stabilizon temperaturën trupore Lartësi dhe fortësi e rregullueshme Anti-alergjik Ideal për çdo pozicion fjetje Lahet në makinë larëse në 40°C Ngjyra: Preferohen me mbështjellës me plot ngjyra dhe figura të dashura për fëmijë	90	Copë	4.50	405.00

8	Batanije për fëmijë mosha 3-5 vjeç (dim. 100x150 cm)	Përmasa: Batanije për fëmijë mosha 3-5 vjeç (dim. 100x150 cm) Materiali: 70% lesh 30% pambuk me mikrofibra natyrale Stabilizon temperaturën trupore Anti-alergjik Lahet në makinë larëse në 40°C Ngjyra: Preferohen batanije një ngjyrëshe.	60	Copë	6.00	360.00
9	Batanije për fëmijë mosha 1-3 vjeç (dim. 50x125 cm)	Përmasa: Batanije për fëmijë mosha 1-3 vjeç (dim. 50x125 cm) Materiali: 70% lesh 30 % pambuk me mikrofibra natyrale Stabilizon temperaturën trupore Anti-alergjik Lahet në makinë larëse në 40°C Ngjyra: Preferohen me dizajnin përplot ngjyra të anijeve kozmike dhe planetëve ose një qiell përplot yje lule dhe flutura.	30	Copë	3.50	105.00
10	Peshqirë për duar (dim. 45 x75 cm)	Përmasa: Peshqir për duar (dim. 45 x75 cm) Materiali: Pambuk organik 100% , Të absorbojnë ujin mirë dhe shpejt. Të ketë po ashtu një dorezë shumë praktike, në qoshe të peshqirit. Shumë i butë në fërkim. Lahet në makinë larëse në 90°C Ngjyra : Preferohen ngjyra e bardhë ose ngjyra të hapura.	20	Copë	2.00	40.00

11	Peceta për enë (dim.45x70cm)	Përmasa: Peceta për enë (dim.40x70 cm) Materiali: Pambuk 100 % , me fibra që absorbojnë ujin mirë dhe shpejt. Lahet në makinë larëse në 90⁰C. Ngjyra: Preferohenngjyra e bardhë ose ngjyra të hapura.	30	Copë	0.70	21.00
12	Mbulesa për tavolina buke të fëmijëve (120x120 cm)	Përmasa : Mbulesa për tavolina buke të fëmijëve (120x120 cm) Materiali Mbulesë tavoline 100%lio- pambuk, shumë i butë në fërkim, përthith lagështinë shumë shpejtë. Perfekt për tu tharë pas larjes. Mundësisht material anti njollave Hekuroset ne një temperature tepër te ulet Lahet në makinë larëse në 40 ⁰C Ngjyra : E bardhë me dizajn të thurur me bordurë në pjesën anësore.	8	Copë	3.50	28.00

13	Kellëf për jastëk (dim.50x100 cm)	Përmasa: Kellëf për jastëk (dim.50x100 cm) Materiali: Pambuk 100% , Të buta Anti - alergjik Lahet në makinë larëse në 40 °C Ngjyra : Preferohenme ngjyra dhe ilustrime për fëmijë.	90	Copë	2.00	180.00
14	Batanije		12	Copë	7.50	90.00
15	Batanije per femije		10	Copë	7.00	70.00
16	Qarshafa komplet per nbuloje		24	Komplet	8.50	204.00
17	Pelena per femije komplet		10	Komplet	5.00	50.00
				TOTALI PERGJITHSHEM:	I	2,963.00€